**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr.2059/12 Prot. Durrës, më 20.12.2019

**VENDIM**

**Nr 68, datë 20.12.2019**
**PËR**
**"MIRATIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURSAVE, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, TË CILËT PËRMBUSHIN KRITERET PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, QË NDJEKIN STUDIMET NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS".**

Në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", nenin 49 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar me Vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave, shkresave të Fakulteteve, shkresës së QSHA nr.5534prot., date 20.11.2019, Bordi i Administrimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në mbledhjen e datës 20.12.2019,

**VENDOSI:**

1. Shpërndarjen e bursave, për vitin akademik 2019 - 2020, për studentë të cilët vijojnë studimet në vitin e parë dhe pas të parit në ciklin e parë të studimeve dhe vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë sipas listës bashkëlidhur të hartuar nga komisioni i verifikimit të bursave, 293 studentë, efekti financiar 26370000 lekë.

2. Shpërndarjen e bursave, për vitin akademik 2019 - 2020, për studentët e shkëlqyer të cilët ndjekin studimet në vitin e parë në ciklin e parë të studimeve, sipas tabelës bashkëlidhur 49 studentë, efekti financiar 4410000 lekë.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
   - Administratori
   - Drejtoria e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Bordit të Administrimit**
**Ilirjana NANO**

**Drakuli LUMI** — **Ervin KARAMUCO**

**Etleva LESKAJ** — **Helena PAPA**

**Hysen HODA** — **Oltjon RRUMBULLAKU**

| Shkresa referuese | Fakulteti | Numri I studenteve te cilet perfitojne burse per vitin 2019-2020 | Efekti financiar per vitin akademik 2019-2020 ( ne leke) | Kriteri perjashtues | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Studente qe vijne nga familje qe trajtohen me ndihme ekonomike | Studente qe jane vete me aftesi te kufizuara | Studente qe kane statusin "jetim" | Studente te shkelqyer viti I dyte dhe I trete | Studente te shkelqyer viti pare sipas shkreses se QSHA -se nr 5534 date 20.11.2019 | Studentët, të cilët i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuara me vendim të Komisionit Mjekësor të | Studentët, të cilët i kanë të dy prindërit pensionist ose njerin prind pensionist dhe tjetri nuk jeton | Studentët, të cilët janë të tretët e lart në rradhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët | Bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy student |
| Shkresa nr. 1221/1 date 18.12.2019 | FSHPJ | 94 | 8,460,000 | 84 | 3 | | | 1 | 2 | 3 | 1 | |
| Shkresa nr. 6520 date 17.12.2019 | FE | 64 | 5,760,000 | 57 | | 1 | | 4 | 1 | 1 | | |
| Shkresa nr. 397 date 17.12.2019 | FTI | 24 | 2,160,000 | 19 | | | | 4 | 1 | | | |
| Shkresa nr. 728 date 17.12.2019 | FSP | 109 | 9,810,000 | 86 | 6 | 1 | | 13 | | 1 | | 2 |
| Shkresa nr. 690 date 17.12.2019 | FB | 46 | 4,140,000 | 20 | 2 | | | 22 | 2 | | | |
| Studente te shkelqyer viti pare sipas shkreses se QSHA -se nr 5534 date 20.11.2019 | FASTIP | 5 | 450,000 | | | | | 5 | | | | |
| TOTALI | | 342 | 30,780,000 | 266 | 11 | 2 | - | 49 | 6 | 5 | 1 | 2 |